



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4718 Prot.

Lezhë, më 19.02.2021

VENDIM

Nr. 48 Datë 17.03.2021

PËR  
MIRATIMIN NË PARIM PËR APLIKIMIN E PROJEKTIT NË KUADËR TË  
THIRRJES “MBI FONDET E PROJEKTEVE TË STREHIMIT PËR VITIN 2021”

Mbështetur ne Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 24 "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", Ligjin 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" si dhe shkresën Nr. 657 prot., Datë 14.01.2021 të ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë "Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

- 1- Të miratohet në parim aplikimi i projektit "Mbi fondet për projektet për strehimin për vitin 2021".
- 2- Aplikimi i projektit do jetë në vlerën 20,000,000 lekë ku Bashkia Lezhë do të angazhohet të bashkëfinancojë 20 % të vlerës totale të projektit (4,000,000 lekë).
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

